



## KUVENDI

### Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 29 qershor 2016, në mbledhjen e XXX-të (tridhjetë) të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Mehmet Gashi, Kryesuesi Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët e Kuvendit.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe, z.Agim Veliu Kryetar i Komunës, z.Nexhmi Rudari Nënkryetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, përfaqësuesi i OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit, dhe një numër i qytetarëve.

### 1. Miratimi i rendit të ditës

**z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, fillimisht përshëndeti të pranishmit, theksoi, thirrja dhe materiali për këtë mbledhje u është dërguar me kohë, ndërkohë në bazë të nenit 33.3 të Rregullores së Punës së Kuvendit, sipas të cilit Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit kanë të drejtë të propozojnë edhe pika shtesë kur ato janë urgjente, kështu që në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) janë paraqitur edhe tri pika shtesë për të cilat kemi diskutuar dhe i kemi rekomanduar Kuvendit për përfshirje në rend të ditës në këtë mbledhje, pika ose propozime të cilat u janë shpërndarë para fillimit të kësaj mbledhje së bashku me rekomandimet e KPF-së, kështu që e hapi debatin nëse ka të lajmëruar për të marrë fjalën, nëse jo mund t'i hedh në votim rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa.

**z.Flakron Gashi**, theksoi, është bërë praktikë që në momentin e hyrjes në këtë sallë ne gjithëherë pothuajse në çdo seancë të marrim pika të veçanta të rendit të ditës, dhe ashtu siç u quajt nga Kryesuesi i Kuvendit, pika me urgjencë, nuk përkojnë të paktën dy pika të rendit të ditës, siç janë, pika apo propozimi i vendimit për iniciimin e procedurave për ndërprerjen e aktivitetit të OJQ - Klubit Publik të Futbollit "Llapi" në Podujevë me qëllim të themelimit të Klubit me organizim në formën e Shoqërisë Aksionare, merrni dhe shikojeni kolegë asamblistë ku të paktën janë 5 - 6 ligje që asamblistët kanë nevojë t'i shqyrtojnë, pastaj ka edhe Udhëzime Administrative, ka nene të ndryshme e që një zyrtari ligjor i marrin kohë të paktën një javë, e lëre më një këshilltari të Kuvendit, andaj nuk është mirë dhe nuk mendoj që ky propozim duhet të kalojë sot në këtë mbledhje por mendoj se është mirë të shtyhet për mbledhjen e radhës sepse mungojnë edhe shumë dokumente tjera të cilat do të duhej të vinin në Kuvendin e Komunës para se të vëhet në votim ky propozim vendim. Klubi i Futbollit "Llapi" nuk është klub politik por përfaqëson ngjyrat e të gjithë qytetarëve dhe të gjitha partive politike. Do të duhej që të kishte një raport financiar për një periudhën dhjetëvjeçare, do të duhej të sjellët Rregullorja e punës së funksionimit të

klubit, mandej se në çfarë mënyre Kryetari i Komunës e ka autorizuar personin përkatës për të mbajtur Kuvendin e Klubit të cilët janë edhe iniciues për hapjen e procedurave për shndërrimin në Shoqëri Aksionare. Unë mendoj se ka shkelje procedurale, mungojnë shumë elemente të cilat do të ishin të nevojshme të hapen për publikun, mandej ai Kuvend i Klubit nëse është mbajtur, në cilësinë e një OJQ-je do të duhej të ishte i hapur dhe do të duhej të merrte pjesë vetë Kryetari i Komunës, pastaj do të duhej të merrnin pjesë edhe mediat sepse nuk është klub privat ashtu siç është shndërruar dhe siç është menaxhuar deri më tani, dhe unë mendoj se ne nuk duhet të marrim hapa sot në këtë mbledhje, nuk është kjo çështje me urgjencë, duhet të na jepet kohë, të sjellët material më i detajuar, dhe të kaloj për mbledhjen e radhës, unë mendoj se për këtë do të ishte pajtuar edhe shefi i zyrës ligjore në Komunën e Podujevës, i cili është në dijeni shumë mirë sepse ka trokitur nëpër shumë dyer të Ministrive të ndryshme për bazën ligjore dhe është në dijeni shumë mirë se nuk janë krejt në rregull të gjitha procedurat.

Gjithashtu do të duhej të shtyhej për seancën e radhës edhe pika apo propozimi i vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike. Mendoj se këto praktika duhet të hiqen prej funksionimit politik dhe funksionimit të mirëfilltë të kësaj asambleje, dhe asamblistët të kenë më shumë kohë të shqyrtojnë bazën ligjore të rasteve konkrete. Vetëm një arsye është pse është bërë në këtë mënyrë dhe të tentohet të futet kjo pikë si pikë e veçantë e rendit të ditës, për arsye se ka shumë lëshime procedurale, ka shumë mangësi, mungojnë shumë dokumente sa i përket funksionimit të KF "Llapi".

**z.Haki Rudari**, theksoi, në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur një ditë më parë, në lidhje me këto tri pika që kanë ardhur me vonesë unë kam dhënë vërejtje, madje vërejtjet kanë qenë vazhdimisht, praktikë kjo e cila po përdoret çdo herë e më shumë dhe mendoj se duhet të ndalohet, në mbledhjen e KPF-së unë e kam thënë se nuk është mirë të futet propozimi për Klubin e Futbollit "Llapi" për arsye se edhe në konsultim me kolegët, materiali është sjellë sot për sot dhe nuk jemi në gjendje të japim mendimet tona, mendoj se materiali duhet të dërgohet me kohë ashtu 7 ditë para seancës ashtu siç është e përcaktuar e jo të sjellët sot dhe sot të votohet për atë pikë e cila është shumë e rëndësishme, madje kemi të bëjmë me një Klub me një traditë të gjatë. Propozoj që pikat ose propozimi për KF "Llapi" dhe propozimi për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike - KEDS, të shtyhen për seancën e radhës, për arsye që kolegët këshilltarë të Kuvendit të Komunës të kenë mundësi të analizojnë dhe të shqyrtojnë më gjerësisht materialet përkatëse.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, në parim mendoj se të gjitha grupet politike, nëse janë zhvilluar të gjitha procedurat në rregull, nuk do ta kundërshtonin as themelimin e shoqërisë aksionare për Klubin e Futbollit "Llapi", absolutisht as për themelimin e Spitalit të Përgjithshëm pikë të cilën e kemi mbështet dhe do ta mbështesim edhe sot, mirëpo çështja e propozimit të vendimit për dhënien e pronave të Komunës KEDS-it dhe propozimit të vendimit për Klubin e Futbollit "Llapi" janë çështje vetëm procedurale e që mendoj se përgjegjësinë duhet ta marrim secili. Sa i përket propozimit të vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike KEDS, unë në mbledhjen e KPF-së e kam pyetur drejtorin e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë se a mund të na e sjellë dokumentin si kërkesë

urgjente me rekomandim të Kryetarit të Komunës, pyetje të cilën e shtroj edhe tani, drejtori i Drejtorisë së cekur u përgjigj se kërkesa ka ardhur me 06 qershor 2016, andaj nëse kërkesa ka ardhur më 06 qershor 2016 dhe futet brenda ditës në mbledhjen e Kuvendit si pikë e veçantë urgjente e rendit të ditës më datën 29 qershor 2016, pyes përse nuk është trajtuar me kohë kërkesa nga ana e drejtorit përkatës. Mendoj se ne si Komunë më së shumti kemi probleme me KEDS-in dhe për këtë pothuajse të gjithë ne jemi pajtuar se rryma më së shumti ndalet në Komunën e Podujevës. KEDS është Kompani private e cila ka profit prej shitjeve të energjisë elektrike, kurse drejtori para disa mbledhjeve ka propozuar një vendim i cili edhe është miratuar ashtu siç drejtori e ka propozuar me shumën përkatëse të kompensimit mirëpo në seancën pasuese po i njëjti drejtor e ka propozuar shfuqizimin e atij vendimi për shkak se KEDS si Kompani private që është, nuk ka pranuar që prona publike komunale të jepet me kompensim por ka kërkuar të jepen pa kompensim, gjë të cilën ne e kemi kundërshtuar por ka kaluar me vota. Pra me 06 qershor 2016 ka ardhur kërkesa dhe as që është marrë me atë drejtori kurse tani me një nguti vie një propozim në Kuvend si pikë e veçantë e rendit të ditës, mendoj se kjo formë nuk është në rregull. Sa i përket pikës shtesë propozimit për Klubin e Futbollit "Llapi", obligimet që i kanë Kuvendi i Klubit, Kryesia e Kuvendit dhe Kryetari i Kuvendit të Klubit para se të shndërrohen në diçka tjetër mendoj se janë në dijeni të gjithë dhe është dashur të vijnë në Kuvendin e Komunës. Unë nuk e besoj se Kryesuesi i Kuvendit din të thotë diçka më gjerësisht tani për tani rreth kësaj çështje para se ta hedh në votim. Nuk është problem se si votojmë ne për, apo kundër, ngase është përgjegjësi e Kryesuesit të Kuvendit të na jap informata apo të na tregoj se si ka funksionuar ajo OJQ dhe si po shndërrohet. Pranimi i Kosovës në FIFA dhe UEFA është bërë shumë më herët, Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe OJQ-ja KF "Llapi" është dashur që shumë më herët t'i përgatitin dokumentet dhe të sjellin materialin me kohë në mënyrë ne të dimë çka të themi për këtë. Ligjet dhe Rregulloret duke përfshirë edhe ato të Federatës së Futbollit të Kosovës nuk janë nxjerrë dje që ne të diskutojmë sot, por pse nuk janë bërë këto harmonizime deri sot dhe cilat janë obligimet dhe çfarë ka ndërmarr Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit deri tani në lidhje me këtë problem. Prandaj propozojmë dhe kërkojmë që propozimi i vendimit për Klubin e Futbollit "Llapi" dhe propozimi për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale Kompanisë KEDS, të shtyhen për një seancë tjetër të radhës në mënyrë që ne të kemi kohë të analizojmë dhe të bëjmë një punë të mira dhe të mos kemi kundërshtime politike.

**z.Agron Gërguri**, U.D. i drejtorit të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, theksoi, mendoj se propozimi i vendimit për inicimin e procedurave për ndërprerjen e aktivitetit të OJQ - Klubit Publik të Futbollit "Llapi" në Podujevë me qëllim të themelimit të Klubit me organizim në formën e Shoqërisë Aksionare, gjithsesi është pikë urgjente sepse është krijuar një moment i ri në sportin kosovar dhe kjo punë është bërë në koordinim me Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit. Ashtu siç jeni në dijeni edhe ju jemi edhe ne që infrastruktura ligjore rreth kësaj çështjeje nuk është ajo që duhet të jetë, andaj mendoj se kjo procedurë ose ky propozim është akti i parë që ne duhet të bëjmë për Klubin e Futbollit "Llapi", përse të mos jemi edhe të parët në ristrukturimin e Klubit. Sa i përket çështjeve që ju i kërkon ato mund të bëhen edhe më vonë, mirëpo propozimi përkatës ka të bëjë me fillimin e një procedure. U tha se Klubi i Futbollit "Llapi" është i të gjithëve, mirëpo më duket se dikush kujdeset më shumë për atë Klub se sa që ai që e ka në kompetencë. Prandaj mendoj se është e rëndësishme të futet si pikë shtesë e rendit të

ditës për këtë mbledhje, e pastaj çështjet tjera që u kërkuan nuk janë çështje të cilat mund të prolongohen apo mund të shtyhen, fshihen apo të mos trajtohen edhe nga ju këshilltarët e Kuvendit, mirëpo mendoj se këshilltarët e Kuvendit e kanë për obligim që ta miratojnë një nismë të mirë në mënyrë që të ristrukturohet Klubi i Futbollit "Llapi", unë kështu e mendoj dhe konceptoj sportin si diçka unifikues, e jo si diçka tjetër.

**z.Flakron Gashi**, theksoi, se sa rëndësi ka sporti, kultura dhe rinia në Podujevë, ne e dimë shumë mirë dhe që sa je drejtor, për herë të parë e more fjalën, kurse tu ka përmend nja 50 herë emri për të bërat dhe të pa bërat. Çështja tjetër është, ju jeni drejtor dhe duhet të njihni rregullat më mirë, për ata që e njohin lëmin fetarë më mirë, taravitë falën pasi që të hahet iftari, andaj ne nuk mund të votojmë propozim vendime ndërsa materialet që është dashur të sjellën sot në këtë seancë të sjellën pas një muaji.

**z.Agron Gërguri**, U.D. i drejtorit të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, theksoi, ne nuk jemi duke biseduar sot për muajin e Ramazanit, nuk është çështje analogjish ajo që parafolësi e tha dhe është analogji e pavend. Mendoj se ju këshilltarët e Kuvendit e keni materialin e mjaftueshëm për çështjen në fjalë, e përsërisë se nuk ka infrastrukturë të mjaftueshme ligjore të saktësuar për këto çështje, por ne po fillojmë një trajtim ndryshe në mënyrë që të gjejmë zgjidhje për ristrukturimin e Klubit në fjalë.

**z.Lutfi Rexhepi**, theksoi, mendoj se u dhanë sqarime të mjaftueshme që këto dy pika shitesë për rend dite sot nuk duhet të trajtohen. E dëgjova arsytimin më të paarsyeshëm të drejtorit të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, i cili e tha se sot mund të merret vendimi e pastaj të sjellën në Kuvend dokumentet tjera përcjellëse. I nderuari Kryesues i Kuvendit, unë mendoj se nuk ka asnjë urgjencë sa i përket propozim vendimeve për KF "Llapi", dhe propozim vendimit për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim KEDS-it, që sot t'i trajtojmë sepse nuk jemi të përgatitur, mendoj se ne duhet të trajtojmë një mori dokumentesh për të marrë një vendim. E vërteta është se drejtori i DKRS-së në mënyrë të tërthorët e tha se ky Klub i cili daton që nga viti 1932, dhe në një formë e tha se nuk është i të gjithëve por është i joni, e që si synim pe di se është që të bëhet i dikujt, sepse kjo veti e sqaron vetë këtë. I nderuari Kryesues i Kuvendit, në vend që sot të sjellët raporti i Auditorit të Përgjegjshëm, dhe në vend që të jetë një raport për shënimin e Ditës së Çlirimit të Podujevës ku Kuvendi i Komunës ka qenë totalisht jashtë dhe nuk ka marrë pjesë në asnjë manifestim, por për fat të keq kolegët e mi në krahut të djathtë në mbledhjen konstituive të Kuvendit të Komunës të patën zgjedhë Kryesues të Kuvendit me ndihmën edhe të ndonjë kolegu tim në krahun e majtë, mirëpo për fat të keq ju si Kryesues i Kuvendit jeni shndërruar në spiker të Komunës dhe pozitën dhe rolin e Kuvendit e keni degraduar shumë.

**z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës**, theksoi, sa i takon pikave të rendit të ditës të cilat kanë hyrë me urgjencë, unë nuk jam ithtarë i asaj që të krijohet një praktikë e tillë, por nganjëherë jemi të shtrënguar që të veprojmë edhe në këtë mënyrë. Lidhur me kërkesën që Klubi i Futbollit "Llapi" të shndërrohet në një Shoqëri Aksionare, unë e kam pranuar që kjo pikë të futet në rendin e ditës për këtë mbledhje për arsye se jam bindur që është çështje urgjente, mirëpo nëse ju vendosni që kjo çështje të shtyhet, atëherë mund të vonohet një vit, sepse në bazë të rregullave nuk mund të fillohet asnjë procedurë e shndërrimit të Klubit të Futbollit "Llapi" në Shoqëri Aksionare apo në forma tjera, në momentin kur fillojnë garat, pra këto janë rregulla të FIFA-së dhe UEFA-së por edhe rregulla të Federatës së Futbollit të Kosovës. Unë kam kërkuar që të plotësohet çdo procedurë dhe të respektohen të gjitha dispozitat ligjore me rastin e propozimit, dhe për

këtë unë kam garanci edhe prej zyrës ligjore, meqë u përmend, dhe nëse ajo më ka vu në lajthitje atëherë është përgjegjësi e tyre, e përsëris se unë kam garancion që janë përfillë të gjitha procedurat ligjore për vendosje nga ana e Kuvendit të Komunës për shndërrimin e Klubit të Futbollit "Llapi" në Shoqëri Aksionare. Në rast se vonohemi ne do të kontribuojmë në dobësimin e Klubit në fjalë sepse klubet tjera të Kosovës tani veç kanë filluar me të madhe këtë proces, dhe nëse klubet tjera këtë çështje e zgjidhin para nesh ndërsa ne vonohemi atëherë ndoshta pa vetëdije do të jemi kontribuues të dobësimit të Klubit, e që besoj se asnjëri prej nesh nuk jemi të interesuar për një gjë të tillë.

U përmenden edhe disa çështje tjera por unë ju garantoj se nuk është duke u bërë asnjë përgatitje askujt dhe për këtë ju garantoj , nëse e keni lexuar propozimin e Vendimit për iniciimin e procedurave për ndërprerjen e aktivitetit të OJQ - Klubit Publik të Futbollit "Llapi" në Podujevë me qëllim të themelimit të Klubit me organizim në formën e Shoqërisë Aksionare, ai është shumë i qartë dhe sipas tij të gjitha asetet i ruan Komuna. Gjithashtu ne kemi propozuar që Komuna të ketë 30% të aksioneve, ndërsa për pjesën tjetër, të formohet komisioni i Kuvendit i cili bënë shpalljen publike për shprehjen e interesit, andaj t'i presim të gjitha ofertat nga të interesuarit për pjesëmarrje në aksione dhe pastaj komisioni përkatës Kuvendit i propozon aksionarët e mundshëm.

Sa i takon kërkesave tjera, unë mundë të pajtohem me disa, mirëpo, për hirë të asaj që të mos vonohemi dhe mos të humbim hapin dhe t'i shkaktojmë dëm Klubit, të aprovohet vendimi sot, ndërsa për një prej mbledhjeve të radhës të kërkojmë çfarëdo raporti që ju jeni të interesuar, për këtë jam dakord për të vetmen arsye që të mos vonohemi.

Lidhur me çështjen tjetër që ka të bëjë me propozim vendimin për dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike KEDS, jam plotësisht dakord me vërejtjen, ngase këtë propozim me vështirësi e kam pranuar që të hyjë si pikë urgjente në rend të ditës, por duke pasur parasysh interesin e banorëve të atyre lokaliteteve të cilët nuk janë fajtor që presin caktimin e lokacionit, qëllimi im ka qenë interesi i qytetarëve dhe kjo është arsyeja përse kam pranuar që edhe kjo pikë të futet pikë shtesë me urgjencë në rendin e ditës. Përndryshe nëse ju mendoni se kjo pikë duhet të shtyhet për një seancë tjetër, unë pajtohem, por vetëm drojë që mos po iu shkaktohet ndonjë problem banorëve të atyre lokaliteteve të cilët presin t'iu përmirësohet cilësia e shpërndarjes së energjisë elektrike përmes vendosjes së trafostacioneve të reja. Andaj propozoj që të miratohet ky rend dite duke përfshirë edhe 3 propozimet apo pikat urgjente, me kërkesën që të jetë obligim paraqitja e raportit të kërkuar, sepse fundja mos paraqitja e raportit nuk është kurrfarë pengese për marrjen e vendimit, ngase kurdo që paraqitet ai do të shqyrtohet dhe do të kërkohet llogari dhe përgjegjësi eventuale, pra raporti nuk mund dhe nuk guxon të jetë pengesë për miratimin e propozim Vendimit për iniciimin e procedurave për ndërprerjen e aktivitetit të OJQ - Klubit Publik të Futbollit "Llapi" në Podujevë me qëllim të themelimit të Klubit me organizim në formën e Shoqërisë Aksionare.

**z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, konsideroj se diskutimet rreth rendit të ditës përfunduan, unë dëshiroj të jap një sqarim rreth vërejtjes së këshilltarit z.Lutfi Rexhepi për punën e Kryesuesit të Kuvendit, mund t'i merrni dhe analizoni raportet për vitin e kaluar dhe për këtë vit nga monitorimi i Kuvendit të Komunës nga ana e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe mund të vëreni se Kuvendi i Komunës së Podujevës është një prej Kuvendeve më normale dhe më efektive si dhe nuk ka asnjë shkelje ligjore në asnjë akt të miratuar të Kuvendit të Komunës, e që një praktikë e tillë

nuk është në shumicën e Komunave të Kosovës, do të thotë se të gjitha subjekteve i është dhënë hapësirë e mjaftueshme, dhe unë si Kryesues i Kuvendit i'u kom përmbajtur ligjit dhe Rregullores së Punës së Kuvendit, ashtu siç jam duke e bërë edhe në këtë mbledhje, unë në fillim i hedha në votim rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, mirëpo u paraqitën disa këshilltarë për diskutim të cilëve edhe i'u dha fjala.

Nga Grupet e këshilltarëve të Partisë Demokratike të Kosovës dhe Lëvizjes Vetëvendosje pati propozime që dy pikat e propozuara dhe të rekomanduara të hiqen, përkatësisht propozimi i vendimit për iniciimin e procedurave për ndërprerjen e aktivitetit të OJQ - Klubit Publik të Futbollit "Llapi" në Podujevë me qëllim të themelimit të Klubit me organizim në formën e Shoqërisë Aksionare, dhe propozimi i vendimit për dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë KEDS, propozim i dy Grupeve të këshilltarëve që do të hedhen në votim dhe nëse shumica e këshilltarëve voton për heqjen e këtyre dy pikave atëherë ato nuk do të përfshihen në rend dite për këtë mbledhje, pra nuk ka kurrfarë problemi ashtu siç miraton Kuvendi ne do të vazhdojmë me punë. Pra e hedh në votim propozimi i Grupit të këshilltarëve nga radhët e PDK-së dhe Grupit të këshilltarëve nga radhët e LVV që pikat e cekura të hiqen prej rendit të ditës.

*Pas votimit u konstatua se me 12 vota për, 21 vota kundër, asnjë votë të përmbajtur, nuk miratohet propozimi i Grupit të këshilltarëve nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës dhe Grupit të këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje që nga rendi i ditës të hiqen pikat, -propozimi i vendimit për iniciimin e procedurave për ndërprerjen e aktivitetit të OJQ - Klubit Publik të Futbollit "Llapi" në Podujevë me qëllim të themelimit të Klubit me organizim në formën e Shoqërisë Aksionare, dhe -propozimi i vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS.*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, e hedh në votim rendin e propozuar të ditës duke përfshirë edhe rekomandimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

*Pas votimit u konstatua se me 21 vota për, 12 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur, u miratua rendi i propozuar i ditës së bashku me rekomandimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa duke përfshirë edhe tri pikat shtesë, dhe atë;*

*Në kuadër të pikës së 6 të rendit të propozuar të ditës të hynë pika,*

• **Propozimi i vendimit për organizimin e kujdesit dytësor shëndetësor – Spital i Përgjithshëm në Komunën e Podujevës**

*Në kuadër të pikës së 7 të rendit të propozuar të ditës të hynë pika,*

• **Propozimi i vendimit për iniciimin e procedurave për ndërprerjen e aktivitetit të OJQ – Klubit Publik të futbollit "Llapi" në Podujevë me qëllim të themelimit të klubit me organizim në formën e Shoqërisë Aksionare**

*Në kuadër të pikës së 8 të rendit të propozuar të ditës të hynë pika,*

• **Propozimi i vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike- KEDS**

*Ndërsa pika 6, të Ndryshme, e propozuar e rendi të ditë, kalon në pikën 9 në kuadër të rendit të miratuar të ditës.*

**2. Shqyrtimi i Ekstrakteve të procesverbaleve të mbajtura në mbledhjet e Kuvendit më 30 mars 2016, 29 prill 2016 dhe në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më 25 maj 2016**

*-Pas votimit njëzëri u miratua Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 30 mars 2016*

*-Pas votimit njëzëri u miratua Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 29 prill 2016*

**z.Haki Rudari**, theksoi, vërejtja ime qëndron te mbledhja e jashtëzakonshme e mbajtur më 25 maj 2016, në faqen 4 të Ekstraktit të procesverbalit ku thuhet "për më shumë se 150,000.00€ për ridestnim, rreth 20% e buxhetit për investime kapitale të shumës së buxhetit për investime kapitale" mendoj se është bërë një gabim sepse duhet të jetë "për më shumë se 950,000.00€ për ridestnim, rreth 20% e buxhetit për investime kapitale të shumës së buxhetit për investime kapitale" pra kështu e kam thënë dhe kështu duhet të jetë.

*-Pas votimit njëzëri u miratua Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 25 maj 2016, me vërejtjen e dhënë nga parafolësi.*

**3. Korniza Afatmesme Buxhetore 2017-2019**

**z.Isuf Latifi**, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave (DBF) e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore - KAB komunale 2017-2019 është pjesë përbërëse e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Republikës së Kosovës dhe është përgatitur në përputhje me procedurat buxhetore 2017-2019 dhe nga Ministria e Financave përmes Qarkores Buxhetore 2017/01. KAB paraqet një mjet si proces të zhvillimit të buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e Komunës duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale për periudhën trevjeçare, dhe me këtë dokument paraqiten shpjegime të politikave prioritare të tanishme dhe të atyre afatmesme prioritare të Komunës së Podujevës me projeksionet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbush projektet më prioritare që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitin 2017 dhe projeksioneve për vitet 2018 dhe 2019, pastaj janë paraqitur objektivat të cilat synohen të arrihen në periudhën e ardhshme trevjeçare, ato janë; krijimi i ambientit të përshtatshëm për biznes, zhvillim i qëndrueshëm i bujqësisë dhe fshatit, zhvillim i qëndrueshëm hapësinorë dhe urban, përmirësim i

infrastrukturës fizike, përmirësim i shërbimeve shëndetësore dhe nivelit të mirëqenies Sociale, sigurim dhe ngritje të cilësisë së arsim, po ashtu KAB 2017-2019 reflekton perspektivën e politikave makrofiscale si, parashikimi i të hyrave komunale sipas llojeve të tyre si dhe parashikimi i shpenzimeve buxhetore sipas programeve dhe kategorive ekonomike. Përmes këtij dokumenti jemi munduar që të paraqesim në mënyrë të qartë një deklaratë të aktiviteteve të Komunës, misionin dhe çështje tjera të rëndësishme nëpër secilën Drejtori ku për secilën ka një përmbledhje të aktiviteteve të nevojshme për të arritur misionin dhe qëllimin e saj, strategji për të arritur aktivitetet e nevojshme, vlerësim të rreziqeve gjatë periudhës buxhetore dhe një plan të përgjithshëm për të adresuar rreziqet, gjithashtu çdo Drejtori ka një sesion të veçantë në matjen e performancës që përfshin deklaratën e misionit, deklaratën e vizionit dhe deklaratën e qëllimit. Në fushën e shpenzimeve në KAB është përfshirë një projeksion trevjeçarë cilat mund të financohen nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake, dhe shpenzimet janë projektuar sipas Drejtorive dhe sipas objektit të shpenzimeve si, paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, komunal, subvencione dhe investime kapitale, po ashtu shpenzimet janë ndarë sipas përqindjes së paraparë në kategoritë dhe programet përkatëse. Shpenzimet e parashikuara baraspeshohen me të hyrat e parashikuara. Çdo Drejtori ka një masë të performancës, masë të arsyeshme dhe ato mund të përmirësohen dhe të jenë indikatorë të vërtetë të performancës. KAB ka seksionin për projekte në investime publike komunale për periudhën trevjeçare sipas listës së projekteve kapitale e cila është e ndarë për vitet përkatëse, projekte të cilat mendohet se do të implementohen dhe që mendohet të financohen nga granti qeveritar dhe nga të hyrat vetanake pa përfshirë edhe financimin nga donatorë të ndryshëm qofshin ata të brendshëm apo të jashtëm.

Për shkak të planifikimit të sigurimeve shëndetësore, të cilat bazuar në Qarkoren Buxhetore 2017/01, do të fillojnë të zbatohen nga fillimi i vitit 2017 për të gjithë të të punësuarit dhe si rezultat i kësaj kemi qenë të detyruar që të ndihmojmë grantin e arsimit duke zvogëluar atë të shëndetësisë sepse arsimit është shpenzuesi më i madh i buxhetit në kategorinë e pagave dhe mëditjeve. Ky dokument është i hartuar në bazë të kufijve fillestar të Qarkores 2017/01 e cila do të pasohet me Qarkore tjera sipas të cilave do të caktohet buxheti final për vitin 2017 dhe projeksionet prioritare për vitet 2018 dhe 2019, mbesim me shpresë që Qarkoret vijuese do të kenë një buxhet më të favorshëm për Komunën e Podujevës. Ju ftoj që ta miratoni Kornizën Afatmesme Buxhetore 2017-2019 të Komunës së Podujevës.

**z.Fidan Rekalju**, theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuara nga Qarkorja buxhetore komunale 2017-2019. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor dhe projeksioneve për dy vitet në vazhdim. Duke ditur rëndësinë e kësaj Kornize Afatmesme Buxhetore për vitet 2017-2019 të Komunës së Podujevës, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim këtë dokument.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, pavarësisht se ky dokument, me propozim të drejtorit parafolës, do të ndërrohet edhe dy apo tri herë deri në vitin 2017, ne prapëseprapë duhet të diskutojmë. Më bëri përshtypje që drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik ka paraparë një shumë prej 15,000.00 € për ndërtimin e shtigjeve për biçikleta dhe po ashtu një shumë të njëjtë për ndërtimin e trotuareve te pishat e Kërprimohut, projekte të parapara në kuadër të zhvillimit ekonomik, konsideroj se këto projekte ose



investime i takojnë ndonjë Drejtorie tjetër sepse nuk di se çfarë zhvillimi ekonomik mund të bëhet dhe çfarë inkasimi i mjeteve mund të bëhen nga këto projekte. Çështja tjetër ka të bëjë me inventarizimin e objektit të ri të Komunës, ku drejtori i Drejtorisë së Administratës që tri vite me radhë është duke sjellë shumën prej 120,000.00 €, projekt i cili në bazë të kontratës së re duhet të përfundoj në muajin dhjetor të këtij viti, gjë të cilën e diskutuam edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, por unë nuk mendoj se do të kryhet ai projekt sipas kontratës, dhe se atë që unë e pash dje edhe sot duke punuar dy punëtorë, vështirë që do të përfundoj ai objekt, andaj sigurisht se kjo shumë e mjeteve prap do të alokohet në fillim të vitit 2017, dhe mendoj se është çështje për diskutim. Gjithashtu që tri vite nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit sjellët propozimi për ndërtimin e fushave të hapura të sportit, kurse që 16 vite nuk ka asnjë fushë të hapur, andaj është mirë, meqë Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e mbështetë këtë dokument, në vitin 2017 të mos e lejoj rialokimin e shumës 90,000.00 €, në mënyrë që të ndërtohen fushat sportive të hapura. Do të ishte mirë që para se të miratohet ky dokument, të ndërrohen toponimet e projekteve të cekura në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik sepse në rast se kërkohet përgjigje nga ana e mediave prej drejtorit përkatës sigurisht se nuk do të ketë përgjigje ngase ato projekte nuk adekuate për zhvillim ekonomik, përndryshe nuk jemi kundër shumës së propozuar për ato dy projekte përkundrazi kërkojmë të rritet buxheti i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik në mënyrë që të kemi paksa zhvillim ekonomik të Komunës së Podujevës, por jemi kundër toponimeve përkatëse gjë për të cilën mendoj se është kundër edhe Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit.

**z.Haki Rudari**, theksoi, për Lëvizjen Vetëvendosje, Korniza Afatmesme Buxhetore KAB është një dokument tejet i rëndësishëm përmes së cilit mund të dihet se cilat projekte janë në implementim dhe cila është agjenda e tyre, po ashtu mendoj se përmes saj duhet të bëhen analiza të hollësishme për shpenzimet publike dhe të përcaktohen prioritetet kryesore për zhvillimin e Komunës në tërësi. Hartimi i KAB-së përveç që është një detyrim për institucionet buxhetore komunale e kërkuar nga Qarkorja Buxhetore 2017-2019 krijon edhe një obligim para qytetarëve për të pasur implementim të projekteve sa më të mira dhe sa më serioze. Në rast se analizojmë KAB 2017-2019 të Komunës së Podujevës me atë 2016-2018, te regjistrimi i bizneseve kemi 6 biznese më pak të regjistruara, andaj kur kemi shuarje të bizneseve nuk mund të themi se kemi zhvillim dhe në një mënyrë shkakton papunësi tek qytetarëve. Në rast se hymë në detaje për projekte të ndryshme të Drejtorive, po ashtu vërejmë disa dobësi të cilat po përcjellën vazhdimisht, madje edhe në seancën e fundit të jashtëzakonshme Kryetari i Komunës bëri vërejtje që këto në një mënyrë të mos përsëriten por të specifikohen se për cilat projekte bëhet fjalë. Në Drejtorinë e Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit, faqe 20 thuhet, ndërtimi, shtrimi, mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave gjelbëruese, kopshteve të hapura dhe lodra për fëmijë, por vetëm thuhet në pronën publike të qytetit, andaj do të ishte mirë që ne ta dimë se për cilën pjesë bëhet fjalë këto investime, pastaj thuhet, zgjerimi, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve "Zahir Pajaziti" dhe "Skenderbeu", në parim është shumë mirë dhe mendoj se është e vonuar kjo, dhe për këtë jeni dijeni se qytetarët dhe bizneset kanë probleme me ujëra të zeza kur ka të reshura apo edhe vërshime, mirëpo ajo që më zgjon kureshtje dhe që dua të di dhe që e shtroj si pyetje është, si mendohet të bëhet zgjerimi i kësaj rruge kur jemi në dijeni se ka kompleks të banesave afër trotuareve. Çështje tjetër është se prap përsëritet, asfaltim i disa rrugëve nëpër lagje të ndryshme të qytetit, shuma

79,746.00 €, dua të them se sërish nuk kemi specifikim të lagjeve ose rrugëve që do të asfaltohen, apo sërish mund të vijmë deri te një ridestinim siç ishte afër 1 milion euro, gjë për të cilën mendoj se është si pasoj mungesa e projekteve nga ana e Drejtorive. Ajo që në parim mendoj se është shumë pozitive dhe që mendoj se është shumë e vonuar është, ndërtimi i bulevardit dhe sheshit të Dëshmorëve Zahir Pajaziti – Hakif Zejnullahu - Ilir Konushevci, kjo është dashur të bëhet shumë më herët, të njëjtën çështje e kemi edhe për, punimi, ndërtimi dhe vendosja e shtatores së Heronjve të Kosovës Zahir Pajaziti - Hakif Zejnullahu – Ilir Konushevci në sheshin e Dëshmorëve dhe prap e kemi edhe vendosjen e Heroit Ali Ajeti dhe ajo që më zgjon kureshtje ta dijë është, pse është shënuar, vazhdim, dhe a mund ta dimë se në cilin vit mund të përfundoj kjo.

Në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, prap përsëritet e njëjta, ndërtimi i trotuareve afër shkollave, shkollat kanë emra dhe dihet cilat janë ato, mandej meremetim i rrugëve me zhavorr shuma 85,000.00 €, mirëpo prap po ka shumë kërkesa dhe ankesa të qytetarëve andaj duhet të ketë më shumë kujdes tek meremetimi. Pastaj vazhdimisht thuhet rregullimi i infrastrukturës së varrezave, shuma 45,000.00 €, a mund ta dimë se për cilat varreza bëhet fjalë, për varrezat e Dëshmorëve apo për varrezat e njerëzve të natyrshëm që kanë vdekur nga natyra, por nuk specifikohet se në cilat vendbanime, fshatra lokalitete etj. Një çështje tjetër për të cilën po ashtu mendojmë se duhet të diskutohet dhe të merret përgjigje nga ana e drejtorëve të Drejtorive, është Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, participim me donatorët në projekte të ndryshme shuma 34,000.00 €, a mund ta dimë se cilat projekte, pastaj pas 16 -17 viteve të çlirimit Komuna lëshon 10,000.00 € për studimin e fizibilitetit për zhvillimin e turizmit në Komunën e Podujevës, a bëhet fjalë për turizmin dimërorë apo për turizmin verorë.

Në Drejtorinë e Administratës, 120,000.00 € të parapara për inventarizimin e objektit të ri të Komunës, a është objekti i ri i Komunës i cili është duke u ndërtuar apo është objekti i ri i Komunës afër hekurudhës ku aty qytetarët edhe hekurudhën e kanë mbuluar me shtresa të betonit për të zhvilluar biznesin e tyre, dhe qeveria komunale dhe Drejtoria e Inspeksionit heshtë. Edhe në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, renovimi i objekteve shëndetësore, a mund të dihet cilat objekte sepse ato objekte të cilat kanë nevojë për renovime ato veç dihen, pastaj është blerja e një kombibusi për bartjen e pacientëve që janë në dializë, projekt i cili është në vitin 2017 dhe të cilën e përkrahim në parim, por e njëjta përsëritet edhe në vitin 2018. Te Drejtoria e Arsimit, zgjerim dhe renovim i objekteve shkollore, krejt është në rregull, mirëpo për cilat objekte bëhet fjalë, prandaj është mirë të specifikohen për arsye se në takime me qytetarë ne nuk po jemi në gjendje t'ju tregojmë se për cilat objekte bëhet fjalë, por për këtë çështje së pari pëson qeveria komunale e pastaj edhe ne këshilltarët në rast se nuk kemi përgjigje. Te Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, kemi projektin në shumë prej 90,000.00 € për ndërtimin e fushave sportive të hapura, pyetje a mund të dimë se në cilat vendbanime do të ndërtohen ato fusha, ngase kërkesat dhe nevojat e qytetarëve janë të shumta. Në fund mund të themi se kemi një Kornizë Afatmesme Buxhetore të Komunës së Podujevës për 2017-2019 me projekte jo të mira për të cilat mendoj se Komuna apo qeverisja komunale është mirë t'i rishikoj edhe njëherë në mënyrë që të jenë pak më cilësore.

**z.Flakron Gashi**, theksoi, pa dashur t'i specifikoj dhe t'i ripërsëris ato që edhe kolegët i cekën, desha të ndalem tek dy - tri çështje. Pjesa e deklaratës së Komunës në lidhje me projektet strategjike zhvillimore ku evidentohet se gjithsejtë në Komunën e Podujevës operojnë 44035 biznese ashtu siç janë specifikuar në faqen 4 të dokumentit, ndërsa tek

indikatorët ekonomik lokal është cekur se numri i bizneseve të regjistruara në Komunën e Podujevës është 3294, pra del se afër 800 biznese operojnë si të paregjistruara, cilat janë nismat komunale dhe përse këto biznese funksionojnë pa regjistruar dhe çfarë hapash janë ndërmarrë apo çfarë hapash do të merrni në të ardhmen. Çështja tjetër është në faqen 5 të Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Podujevës për 2017-2019, korniza fiskale komunale shihet se plani për vitin 2017 për administratën komunale është më i lartë fondi i garantuar prej 1.34 milion euro, ndërsa për arsimin është plani ku shuma është e zvogëluar për 748,000.00 €, unë do të doja sqarime ose nga drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave ose nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit, se a do të ketë impakt ose ndikim në arsimin e Komunës së Podujevës ky planifikim. Çështja tjetër, meqë shumë herë është folur në Komunën e Podujevës për zhvillimin ekonomik lokal, unë do të cekë dy - tri fakte të cilat janë shqetësuese por ndoshta janë edhe absurde, ta zëmë, Komuna e Podujevës për 10,000.00 € ka mbetur deri tani pa e funksionalizuar zyrën për menaxhim të projekteve zhvillimore me Partneritet Publiko Privat, me donatorë dhe promovimin e investimeve si dhe ngritjen e inkubatorit të biznesit, në një projekt janë tri - katër projekte, dhe nëse këto kanë mbetur pa u realizuar për 10,000.00 € në një Komunë e cila ka buxhetin vjetor mbi 17 milion euro, kjo është e tmerrshme për zhvillimin ekonomik lokal. Në Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Podujeva me afër 90000 banorë rezident, fond i garantuar në një projekt, ndërtimi i fushave të hapura, shuma 90,000.00 €, unë jam shumë i bindur që qytetarët e Komunës së Podujevës, vetëm për një javë, duke marrë parasysh edhe këtë kohë aktuale kur është duke u zhvilluar kampionati evropian i futbollit, këtë shumë e kanë fara, ndërsa Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, absolutisht nuk bënë asgjë dhe nuk insiston në Ekzekutiv që fondi i saj të rritet, duke ditur që kemi një moshë të re, pastaj një kohë figuronte salla e kulturës, ndërsa tani është hequr edhe ajo, nuk di secili do të jetë fundi dhe bilanci.

**z.Durim Salihu**, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit (DPUMM), theksoi, dëshiroj të jap disa sqarime rreth disa pyetjeve të këshilltarëve parafolës. Sa i përket pyetjeve apo çështjeve të ngritura nga z.Haki Rudari, unë mendoj se duke respektuar kërkesat zyrtare të drejtuara DPUMM-së nga ana e komuniteteve të fshatrave dhe atyre të qytetit të Podujevës, ato që janë vlerësuar dhe të cilat janë më të arsyeshme duke i vlerësuar së bashku në takimet publike buxhetore të mbajtura në fshatrat Lluzhan, Kërpimeh dhe së fundi edhe në qytet, ne kemi parë të arsyeshme t'i fusim këto prioritetet që janë në dokument, edhe pse jemi në dijeni se ndoshta janë disa kërkesa të cilat nuk kemi mundur t'i plotësojmë për vitin e ardhshëm, mirëpo unë mendoj se të gjitha ato projekte të cilat i kemi planifikuar në Qarkoren Buxhetore 2017/01, janë projekte serioze dhe kanë peshën dhe rendësin e vet. Sa i përket zgjerimit të rrugëve "Zahir Pajaziti" dhe "Skenderbeu" ne në harmoni me dimensionet dhe koordinatat gjeodezike që disponon Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, kemi vlerësuar se ka hapësira të mjaftueshme për zgjerimin e tyre, po ashtu jemi duke bërë studimin e fizibilitetit se a kemi mundësi që rrugët e cekura t'i bëjmë me nga 4 korsi apo me tri korsi por e rëndësishme është se zgjerimi do të ndodh, ndërsa sa i përket asfaltimit të disa rrugicave në vitin 2017, është kod i veçantë dhe nuk ka të bëjë me kodin për zgjerimin e dy rrugëve të lartcekura, kurse nuk janë specifikuar saktësisht rrugët për shkak se për disa rrugë mungojnë projekte konkrete, rrugët janë të distancave të shkurtra 50 deri 100 m, për të cilat jemi duke negociuar me banorët e rrugëve përkatëse në mënyrë që të gjejmë një zgjidhje, dhe sigurisht se me rastin e përgatitjes së Qarkores 2017/02 do të

specifikohen të gjitha rrugët të cilat do të asfaltohen ashtu siç janë specifikuar projektet tjera. Sa i përket shesheve të Dëshmorëve dhe ndërtimit të shtatores së Heroit Ali Ajeti, mendojmë se është një projekt voluminoz dhe me një kosto të lartë të ekzekutimit, andaj kemi menduar që të filloj në vitin e ardhshëm, duke shpresuar se ndërtimi i bulevardit dhe zgjerimi i rrugëve të cekura së bashku me sheshet në fjalë do të përmbyllen në vitin e ardhshëm, mirëpo për çdo rast kemi planifikuar buxhet edhe për vitin pasues që në rast se nevojiten mjete shtesë të kemi të planifikuara.

**z.Fatmir Gashi**, drejtor i Drejtorisë së Administratës, theksoi, sa i përket çështjes së ngritur rreth mjeteve të parapara për inventarizimin e objektit të ri të Komunës, ne sigurisht se për herë do të planifikojmë mjete për atë çështje përderisa të përfundoj ai projekt. Ky planifikim është bërë mbi bazën e faktorëve të cilat janë të kyçur në ndërtimin e objektit, mirëpo për fat të keq, pse ka ardhur deri te ngecja e punimeve në objektin e cekur, jeni të informuar mirë të gjithë, por kësaj radhe shpresojmë shumë se do të përfundojnë punimet dhe do të kryhet objekti dhe do të përfundoj edhe çështja e mjeteve të planifikuara për inventarizim të objektit të ri në mënyrë që pastaj ta funksionalizojmë atë objekt ku edhe do të krijohen kushte dhe hapësira më të mira për stafin e punonjësve të Komunës. Pra mjetet janë të parapara për inventarizimin e objektit të ri të Komunës në të cilin janë duke u zhvilluar punimet.

**z.Faik Muçiqi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit (DSHPMSH), theksoi, fillimisht ndjehem mirë që nuk patëm asnjë propozim të ri nga ana e këshilltarëve ngase kjo nënkupton që me planifikimet tona në këtë dokument si draft i parë, ne ja kemi qëlluar, edhe pse zakonisht drafti i parë është shumë i hapur për diskutime dhe unë sot nga këshilltarët e Kuvendit prita që do të ketë propozime konkrete të ndonjë projekti që eventualisht kemi mund të harrojmë apo të mos e planifikojmë fare në këtë Kornizë, mirëpo kjo do të thotë që me këto planifikime jemi në kornizat ku planifikimet janë në përputhje me interesat e të gjithëve. Është e vërtetë se disa kode janë të përgjithësuara, mirëpo vetë natyra e tyre bënë që të jenë të përgjithësuara sepse, shembull, meremetimi i rrugëve me zhavorr, është një listë shumë e madhe e rrugëve dhe kërkesave të cilat do të meremetohen me zhavorr, pastaj e njëjta gjë qëndron edhe me trotualet, etj. Sa i përket rregullimit të trotualet në rrugët kryesore të asfaltuara afër shkollave ne synojmë që në këtë vit dhe në vitin e ardhshëm, me përjashtim të rrugës magjistrale, do t'i rregullojmë të gjitha trotualet afër shkollave. Sa për njoftim, buxheti i DSHPMSH kryesisht është koncentruar në kolektorë – vazhdimi i tyre, trotualet, zgjerim të lumenjve, ndriçim mbi 50% të investimeve kapitale. Sa i përket pyetjes rreth investimeve afër varrezave se a bëhet fjalë për varreza të Dëshmorëve apo varrezave të zakonshme, për infrastrukturën afër varrezave nuk kemi bërë dallime sepse varrezat janë të të gjithëve dhe synimet kryesore janë përmirësimi dhe rregullimi i infrastrukturës afër të gjitha varrezave të Komunës së Podujevës, kryesisht rrugët dhe trotualet dhe eventualisht tek ndonjë varrezë rrethojat, pra nuk bëhet fjalë për mirëmbajtje të varrezave por për infrastrukturë të varrezave.

**z.Agron Gërguri**, U.d. i drejtorit të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit (DKRS), theksoi, kultura, rinia dhe sporti është shqetësim i të gjithë neve, dhe duhet të mundohemi të gjithë që të gjejmë forma që fondet për kulturë, rini dhe sport të rriten më shumë. Sa i përket asaj që u tha se po përsëritet projekti për ndërtimin e fushave sportive të hapura, nuk është çështja që ne jemi duke e përsëritur ndërtimin e një fushe të hapur sportive, sa për njoftim, një objekt sportiv është duke u realizuar dhe është në ndërtim e sipër,

gjithashtu do të ndërtohet një fushë e hapur sportive edhe në fshatin Kërpimeh, si dhe do të ketë ndërtime të tilla edhe në lokalitetet ku do të paraqitet nevoja në mënyrë që atyre banorëve t'ju krijojmë mundësi të zhvillojnë aktivitete sportive.

**z.Lutfi Rexhepi**, theksoi, nga praktikat e deritanishme, është krejt njësoj të japësh propozime, ide, sugjerime, qortime etj etj, sepse këtij Kuvendi Komunal dhe këtij Ekzekutivi asnjëherë nuk i kanë munguar dokumente dhe planifikime për zhvillim, mirëpo asnjëherë nuk i është përmbajtur atyre, madje madje edhe projektet në vitet kalendarike me një përqindje të lartë janë destinuar sepse nuk janë realizuar, prandaj këtu goxha vjen në shprehje ajo që thuhet, fol e rruaj vo. Nuk di se çka mund të propozojmë ne, projektet e juaja janë tepër të përgjithësuara dhe më krijohet përshtypja që të vetmin zotim që Ekzekutivi e jep në këtë Kornizë është se buxheti do të harxhohet qysh të mundet dhe ku të mundet. Duke pasë parasysh që po afrohet fundi i mandatit të kësaj asambleje dhe këtij Ekzekutivi, shumë qartë duket që ky buxhet do të orientohet në fushatë, mandej kushtimisht e them "në blerjen e votave" ashtu siç praktikisht ka ndodhur në këto vite qoftë duke bërë punësime me kohë të caktuar, qoftë me subvencione dhe me gjëra tjera. Prandaj nganjëherë është e pakuptimtë që të propozohet diçka. Madje gjatë këtij mandati, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik që është njëra prej Drejtorive kyçe sepse duhet të bëjë planifikimet e zhvillimit dhe të gjejë format, duke parë që ky Ekzekutiv nuk ka objektiva dhe ai drejtor nuk ka se çka të bëjë, atij i është bërë vendi në një Drejtori tjetër vetëm sa për të mos marrë pagën kot në Drejtorinë e cekur.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, vazhdimisht që 1 ose 2 vite tek Lagja Statovci në fshatin Batllavë, tek Ibrahim Bajrami është kërkesa për ndërtimin e një ure, për gjendjen në atë Lagje besoj se edhe ju jeni në dijeni dhe e keni parë se është e keqe, mirëpo edhe pse jemi duke diskutuar për projektet për vitin e ardhshëm do të ishte mirë që ta keni parasysh atë kërkesë për shkak se në atë Lagje jetojnë disa familje të cilat janë në gjendje jo të mirë ekonomike, andaj do të ishte mirë që Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit ta ketë parasysh që nga fondi i planit të emergjencave të planifikon që në vitin e ardhshëm të ndërton atë urë, sepse mendoj se nuk është një barrë e madhe buxhetore e cila do të lëvizte projektet tjera, edhe pse jam në dijeni se në raste të vërshimeve krijohen barra tjera buxhetore nga intervenimet.

**z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës**, theksoi, te përshtypja e projekteve në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, projekti i emërtuar; punimi, ndërtimi, vendosja e monumentit të Tre Heronjve të Kosovës Zahir Pajaziti – Hakif Zejnullahu – Ilir Konushevc, dhe punimi, ndërtimi, vendosja e shtatores së Heroit Ali Ajeti, të riformulohet në mënyrë që t'iu ndërrohet vendi dhe fillimisht të realizohet vendosja e Shtatores së Heroit Ali Ajeti e pastaj të vendoset shtatorja e Tre Heronjve të lartcekur, duke pas parasysh që shtatorët e Tre Heronjve të lartcekur janë të ngritura nëpër lokalitete tjera, dhe për këtë të fundit nëse nuk mjaftojnë mjetet financiare me rishikim të buxhetit të ndajmë mjete për realizimin e plotë të këtij projekti.

Sa i përket diskutimit të këshilltarit Lutfi Rexhepi i cili tani ka ikur nga salla por paraprakisht lëshoi disa fjalë plotësisht të pabazuara ngase për mua është shumë interesante se si një pushtet lokal, siç e ceku i përmenduri, nuk ka planifikime, nuk ka projekte, nuk din të punoj etj, ndërsa siç jemi në dijeni vazhdimisht çdo herë i fiton zgjedhjet. E kam thënë disa herë dhe po e përsërisë edhe sot se në Komunën e Podujevës nuk ka investime të karakterit politik ashtu siç potencohet nga ndonjëri prej këshilltarëve të Kuvendit, sepse të gjithë jemi në dijeni se nuk ka as lagje, as lokalitete, as

fshatra që janë të ndara në aspektin e përkatësisë partiake, pavarësisht nga kjo ne jemi duke punuar në rregullimin e infrastrukturës në gjithë territorin e Komunës së Podujevës. Andaj nuk është mirë të lëshohen fjalë dhe të iket nga salla, ngase kam pyetje për këshilltarin e përmendur që të na tregojë për çmimin e blerjes së votës, sepse ai sigurisht paska ndonjë përvojë të tillë, pra ta dimë se cili është çmimi i votës ngase ne nuk kemi blerë vota ngase nuk kemi pasur nevojë të blejmë, andaj edhe nuk e dimë as çmimin e tyre. po ashtu të njëjtin e lus të jetë më serioz ngase është duke ja futur kot në çdo seancë.

**z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, falënderoj parafolësit për diskutimet dhe kontributin e tyre rreth kësaj pike të rendit të ditës, gjithashtu pati disa propozime konkrete, dhe ju njoftoj se për propozime, vërejtje dhe sugjerime tjera rreth projektbuxhetit të Komunës për vitin 2017 dhe prioriteteteve për vitet 2018 dhe 2019, mund t'i jepni deri në fund të muajit shtator, andaj meqë diskutimet për këtë pikë u kryen, unë e hedh në votim Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Podujevës për periudhën 2017 – 2019, duke përfshirë edhe korrigjimet e bëra në projektin e lartcekur nga Kryetari i Komunës.

*Pas votimit u konstatua se me 21 vota për, asnjë votë kundër dhe 9 vota të përmbajtura u konstatua se miratohet Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Podujevës për vitet 2017 – 2019.*

#### **4. Plani i Veprimit për Energji të Qëndrueshme për Komunën e Podujevës**

**z.MehmetGashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa e kemi shqyrtuar këtë propozim dhe i kemi rekomanduar Kuvendit për miratim. Prezent në sallë është edhe koordinatori i këtij projekti z.Rasim Fejza të cilit ja jap fjalën hyrëse rreth këtij plani.

**z.Rasim Fejza**, koordinatori për energji në kuadër të administratës së Komunës e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, Plani i Veprimit për Energji të Qëndrueshme - PVEQ është hartuar në kuadër të projektit të Asociacionit të Komunave të Kosovës, dhe është financuar dhe përkrahur nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim si dhe nga Qeveria Zvicerane, dhe është implementuar përmes Fondit të Hapur Regjional për Modernizimin e Shërbimeve Komunale dhe Fondit të Hapur Regjional për Efiçencë të Energjisë të Shoqatës Gjermane për Bashkëpunim - GIZ.

Gjatë periudhës 2012 – 2013, Komuna e Podujevës ka zhvilluar dhe adoptuar për të parën herë Planin Komunal për Efiçencë të Energjisë - PKEE, që është miratuar nga Kuvendi i Komunës, në kuadër të projektit të direktivave të Bashkimit Evropian “Promovimi i Efiçencës së Energjisë dhe burimeve të ripërtritshme të energjisë”. Andaj përmes adaptimit dhe implementimit të PKEE, janë zhvilluar me sukses kapacitetet e strukturave komunale për të adresuar çështjet e energjisë. Jemi në dijeni se Komuna e Podujevës ka burime të shumta të energjisë së ripërtritshme si, të erës, ujit dhe të energjisë solare. Përdorimi i energjisë së burimeve të ripërtritshme do të mundësonte furnizim të rregullt me energji efiçente dhe do të ndikonte pozitivisht në mjedis pasi që në masë të madhe do të ullej emetimi i gazrave CO2 si në fushat e ndërtimit, transportit publik, ndriçimit, amvisëri dhe inxhinieri.

Në vitin 2014, në kuadër të projektit të GIZ, Asociacioni i Komunave të Kosovës ka shpallur tenderin publik për pilot projektet që synojnë të promovojnë ide të reja që lidhen me politikën dhe planifikimin strategjik të energjisë në nivelin lokal. Përmes këtij projekti, Komuna e Podujevës kishte shprehur interesin për të zhvilluar PVEQ që shkon përtej PKEE dhe tregon gatishmërinë dhe përkushtimin për të reduktuar emisionin e CO2 më shumë se 20% deri në vitin 2020, përmes zhvillimit dhe zbatimit të projekteve për efikasitet energjetik dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtrishme të energjisë, Komuna e Podujevës së bashku me AKK, GIZ dhe SDC ka përfunduar hartimin e Planit të Qëndrueshëm të Veprimit për Eficiencë të Energjisë (SEAP) me synim që të anëtarësohet në familjen e madhe të qyteteve që kanë marrë apo premtojnë marrjen e masave për zvogëlimin e emetimit të gazrave serë, me nënshkrimin e Konventës së Kryetarëve (The Covenant of Mayors), pasi që planet komunale për eficiencë të energjisë PKEE nuk e mbulojnë fushën që e trajton energjinë, atëherë ne kemi bërë Planin e Qëndrueshëm për Eficiencë të Energjisë, plan i cili është shumë voluminoz dhe që duhet të realizohet deri në vitin 2020.

Komuna e Podujevës është Komuna e parë në Republikën e Kosovës e cila shpreh interes për tu bashkuar me Konventën e Iniciativës së Kryetarëve të Komunave të shteteve të ndryshme të botës në Komisionin Evropian me seli në Bruksel, dhe për zhvillimin e Planit të Veprimit të Energjisë së Qëndrueshme. Andaj siç jemi në dijeni, më 15 tetor 2015, Kryetari i Komunës së Podujevës z.Agim Veliu ka nënshkruar mënyrë ceremoniale Konventën e Kryetarëve të Komunave dhe është zotëruar se administrata komunale do të promovojë eficiencën e energjisë në nivel lokal duke implementuar një numër të rëndësishëm të projekteve dhe masave të eficiencës së energjisë në ndërtesat publike si, shkolla, çerdhe të fëmijëve, objekte shëndetësore, në sistemin e ndriçimit të rrugëve, etj. Plani i Veprimit për Energji të Qëndrueshme - PVEQ është dokumenti kryesorë i cili në bazë të të dhënave të mbledhura në situatën aktuale, identifikon dhe jep udhëzime të sakta dhe të qarta për zbatimin e projekteve dhe të masave të eficiencës së energjisë dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtrishme të energjisë në nivelin komunal, të cilat rezultojnë në zvogëlimin e emisioneve të CO2 në më shumë se 20% deri në vitin 2020 duke i kontribuar objektivave energjetike dhe klimatike me parametra 3x20 të Traktatit të Komunitetit Evropian për energji me seli në Vjenë, që do të thotë, kursimi i energjisë 20%, reduktimi i CO2 20% dhe viti 2020. Komisioni Evropian ka rekomanduar vitin bazë të jetë viti i parë i cili ka të dhënat e Komunës së Podujevës e cila në vitin 2012 ka filluar me ofrimin e të dhënave të kërkuara dhe prej atij viti fillojnë realizimi i projekteve që janë në këtë plan. Andaj në bazë të rekomandimeve të Komisionit Evropian kërkohet nga Kuvendi i Komunës miratimi i këtij Plani në mënyrë që në afatin e caktuar kohorë përmes Komisionit Evropian këtë plan ta dërgojmë në Bruksel.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, ky dokument është dërguar me kohë dhe të njëjtin e kemi shfletuar dhe analizuar dhe si të tillë edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa ne si Grup e kemi mbështetë dhe e mbështesim edhe në këtë mbledhje. Pra e mbështesim dhe i japim përkrahje këtij Plani, si dhe kërkujmë dhe Inkurajojmë implementimin e tij deri në vitin 2020.

**z.Flakron Gashi**, theksoi, në parim orientimi jonë si vend tregon se në çfarë drejtimi jemi duke shkuar dhe besoj se do të ishte mirë që sa më shpejt të realizohet ky projekt i cili është i pranueshëm dhe do ta mbështesim, mirëpo si informatë shtesë, tek ku burojnë detyrat e qeveris komunale në realizimin e Planit të Veprimit për Energji të Qëndrueshme

është edhe sigurimi i mjeteve financiare për zbatimin e këtij Plani, pyetje, cila është kostoja financiare dhe a mundet Komuna ta përballoj atë, dhe a është parashikuar të kërkohej ndonjë donatorë nga jashtë duke pasë parasysh koston e lartë të këtij projekti.

**z.Fidan Rekaliu**, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e përshëndesim Planin përkatës dhe njëkohësisht e përshëndesim edhe punën dhe përkushtimin e Kryetarit të Komunës z.Agim Veliu bashkërisht me Ekzekutivin e Komunës për avancimin e Komunës së Podujevës në të gjitha fushat të cilat ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

**z.Rasim Fejza**, koordinator për energji në kuadër të administratës së Komunë, Plani në fjalë parashihet të realizohet deri në vitin 2020, do të thotë projektet që janë në kuadër të planit. Me projekte janë të involvuara të gjitha Drejtoritë e Komunës ku disa nga projektet janë realizuar sepse në këtë drejtim është duke u punuar që nga viti 2012, por ka projekte tjera të cilat parashihen të përfundojnë deri në vitin 2020, ka edhe donacione për realizim të projekteve të përfshira në Plan dhe për këtë unë në vazhdimësi interesohem në gjetjen e donatorëve të jashtëm ku edhe besoj se do të arrijmë qëllimet tona në funksion të implementimit të këtij Plani.

**z.MehmetGashi**, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka këshilltarë tjerë të lajmëruar për diskutim, e hedh në votim këtë propozim Plan, duke përfshirë edhe korigjimin e dhënë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, përkatësisht rreth organogramit të Komunës.

*Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozim Plani i Veprimit për Energji të Qëndrueshme për Komunën e Podujevës.*

## **5. Propozimi i vendimit për fillimin e procedurave për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Podujevës**

**z.Durim Salihu**, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, ne si Drejtori detyrimisht jemi të obliguar të fillojmë me procedurat e hartimit të Hartës Zonale e cila sikurse çdo komune tjetër i ndihmon realizimin e qëllimeve të parapara në Planin Zhvillimor Komunal. Hata Zonale është edhe obligim ligjor, andaj ju ftoj ta miratoni këtë propozim në mënyrë që fillohen me procedura të prokurimit për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Podujevës.

**z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, për këtë propozim vendim ne edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kemi debatuar dhe i kemi rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim. Është propozim sipas të cilit hapen rrugët për procedim të mëtutjeshëm për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Podujevës, dokument ky mjaft i rëndësishëm, andaj meqë nuk ka këshilltarë të lajmëruar për diskutim, e hedh në votim.

*Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozimi i vendimit për fillimin e procedurave për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Podujevës.*



## **6. Propozimi i vendimit për organizimin e kujdesit dytësor shëndetësor – Spital i Përgjithshëm në Komunën e Podujevës**

**z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, në fillim të kësaj mbledhje u miratuan rekomandimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa ku pjesë e tyre ishte edhe ky propozim vendim, mirëpo për të qenë sa më të sqaruar rreth kësaj pike, fjalën e ka kërkuar Kryetari i Komunës.

**z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës**, theksoi, dëshiroj të falënderoj të gjithë këshilltarët e Kuvendit, njëkohësisht edhe anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa të cilët në mbledhjen e mbajtur një ditë më parë kanë pranuar dhe e kanë mbështetur që ky propozim vendim të futet me procedurë të përshpejtuar në rend të ditës për këtë mbledhje të Kuvendit. Konsideroj se miratimi i këtij propozim vendimi është një prej vendimeve më të rëndësishme të Kuvendit të Komunës në këtë mandat. Besoj se pas përfilljes së procedurave tjera që kërkohen me ligj, ne do të arrijmë që të themelojmë një Spital të Përgjithshëm të Qytetit, fillimisht me disa shërbime e pastaj duke u zgjeruar edhe me shërbime tjera të kujdesit dytësor shëndetësor. Pra pa dashur t'i jap merita askujt në lidhje me këtë çështje, e as vetes, unë i falënderoj të gjithë për mbështetjen që ky propozim vendim është futur në rend të ditës, si pikë urgjente dhe të cilin sigurisht do ta përkrahni të gjithë, sepse e ritheksoj se është një prej vendimeve ndoshta më i rëndësishmi i kësaj përbërje të Kuvendit të Komunës së Podujevës.

*Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozim vendimi për organizimin e kujdesit dytësor shëndetësor – Spital i Përgjithshëm në Komunën e Podujevës.*

## **7. Propozimi i vendimit për iniciimin e procedurave për ndërprerjen e aktivitetit të OJQ - Klubit Publik të Futbollit “Llapi“ në Podujevë me qëllim të themelimit të Klubit me organizim në formën e Shoqërisë Aksionare**

**z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, në fillim të kësaj mbledhje në një formë u debatua në lidhje me këtë propozim vendim, mirëpo në këtë propozim parashihet edhe ngritja e një komisioni të veçantë për zhvillimin e procedurave të shprehjes së interesit dhe propozimit të aksionarëve në Klubin e Futbollit “Llapi”. Pyetja ime është se a dëshironi që ky komision të jetë ai i cili është ngritur më parë përkatësisht komisioni për dhënien e pronave të komunës në shfrytëzim, apo dëshironi të ngritet një komision me një përbërje tjetër.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, ne në fillim kërkuam që ky propozim vendim të shtyhet për një mbledhje tjetër të radhës, mirëpo pas votimit kjo pikë hyri në rend të ditës për këtë mbledhje dhe tani gjendemi në një proces tjetër. Mendoj se propozimi i Kryesuesit të Kuvendit që komisioni për dhënien e pronave të komunës në shfrytëzim, të jetë ai i cili do të merret me çështjen e Klubit të Futbollit “Llapi”, ishte një propozim shumë interesant dhe nuk di se kah erdhi ajo ide për të cilën mendoj se as Kryetari i Komunës nuk e pranon një propozim të tillë, ngase nuk kemi të bëjmë me dhënien e pronave të komunës në shfrytëzim dhe kjo çështje është shumë mirë e cekur në propozim vendim që prona të

cilën KF "Llapi" e ka në shfrytëzim ajo mbetet në pronësi të Komunës, andaj nuk di se a e a lexuar Kryesuesi i Kuvendit këtë propozim vendim ngase në të thuhet që do të ngitet një komisioni veçantë për zhvillimin e procedura për shprehjen e interesit dhe përzgjedhjen e aksionarëve të Klubit. Çështje tjetër, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, kemi diskutuar edhe më parë se duhet të përfshihemi në shumicën e komisioneve dhe komiteteve ku nuk kemi përfaqësues, pavarësisht se ne gjithëherë punët tona do të kryhen si punë të përgjegjshme, e jo në interes të ndonjë individi, mirëpo një hap i tillë nuk është marrë nga ana e Kryesuesit të Kuvendit, po ashtu mendoj se Kryetari i Komunës nuk është i obliguar ta përcjellë çdoherë Kuvendin e Komunës, por Kryesuesi i Kuvendit është i obliguar ta njoftoj për të gjitha çështjet. Sa i përket rekomandimit të Kryetarit të Komunës në propozim vendim për përbërjen e komisionit në fjalë, meqë përbërja e Kuvendit përbëhet nga 4 Grupe të këshilltarëve, ne si Grup nga radhët e PDK-së propozojmë që përbërja e komisionit të ndryshoj nga ajo siç ceket në propozim vendim, dhe atë, nga 1 anëtar prej secilit Grup të këshilltarëve dhe 1 anëtar nga Ekzekutivi i Komunës. E kuptoj tendencën e Ekzekutivit të Komunës që në përbërje të këtij komisioni të ketë 2 anëtarë nga radhët e Ekzekutivit të Komunës dhe 1 nga radhët e Grupit të këshilltarëve të LDK-së, që në raste të votimit nga ana e komisionit të ketë numrin e votave të mjaftueshme, mirëpo për qytetarët e Komunës së Podujevës dhe Klubin i Futbollit "Llapi", të jeni të bindur se në raste se është gjithçka në rregull dhe vie deri te një situatë e tillë, Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së do të votoj pro koncept dokumentit përkatës, por nëse diçka nuk është në rregull me dokumentin përkatës dhe me vota kalon, ne do të bëjmë publike atë, kështu që nuk besoj që është e arsyeshme që Ekzekutivi i Komunës të ketë dy anëtarë pasi që Kuvendi i Komunës është ai i cili merr vendim, andaj konsideroj se kjo nuk është mirë as për Kryesuesin e Kuvendit, sepse në qoftë se vendimi është i mirë dhe në rregull ne do ta votojmë ashtu siç votuam për disa propozim vendime paraprake. Pra konsideroj se ky pasus, me mirëkuptim dhe me të drejtë, kalon me përbërje të 4 anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe 1 nga Ekzekutivi i Komunës, e që do të mirëpritej mirë edhe nga qytetarët dhe nga Klubi i Futbollit "Llapi", Nuk është mirë që pastaj të dalim kundër ndonjë propozimi të ndonjë Grupi të këshilltarëve, por të bëjmë një përfshirje të mirë dhe që kushdo që propozohet nga radhët e anëtarëve të Kuvendit në atë komision, kërkoj që puna të jetë ekipore dhe punë e mirë sepse ne jemi me mandat të caktuar kurse vendimi për Klubin e Futbollit "Llapi" do të mbetet si dokument në arkiva për një kohë të gjatë.

**z.Flakron Gashi**, theksoi, u tha edhe nga shefi i Grupit të këshilltarëve nga radhët e PDK-së z.Rafet Llapashtica, se tani kemi një stad të ri të situatës. Kryetari i Komunës në diskutimin e tij e tha se, më ka bindur Klubi që të fillohet me procedura për shuarjen e OJQ -së dhe kalimit në Shoqëri Aksionare, mirëpo mos harroni i nderuari Kryetar se ju jeni edhe Kryetar i Klubit, ndërsa të tjerët paskan arritë të të bindin sepse ju nuk keni pasur vizion, përndryshe personi i cili është nënshkruar për ty si Kryetar i Klubit, sepse në atë takim sipas rregullave duhet të ishit prezent ju, a ka qenë i autorizuar dhe ai autorizim a është bërë te avokati, a është vërtetuar në Gjykatë dhe a ka kaluar me procedurë tek noteri, pra këto janë rregulla të cilat nuk do të duhej shpërfillur. Gjithashtu Kuvendi i Klubit do të duhej të ishte i hapur, pastaj do të duhej ta kishim ne listën e anëtarëve të cilët kanë marrë pjesë dhe që kanë vendosë dhe kush e ka kryesuar atë takim, mandej do të duhej të kishim rregullore të punës së atij bordi, do të duhej të kishim rregullore të punës së Kryetarit, një kod financiarë dhe raportin financiar të Klubit për një periudhë 10 vjeçare,

kush e ka subvencionuar dhe kush ka dhënë kontribute për Klubin, në mënyrë që ta kemi një pasqyrë të qartë sepse ajo ka qenë një OJQ e themeluar në Komunën e Podujevës. Pastaj tek neni 4 i propozim vendimit përkatës ku thuhet, Kuvendi i Komunës e ngritë Komisionin e veçantë prej 5 anëtarëve, prej të cilëve 3 anëtar nga përbërja e Kuvendit të Komunës dhe 2 anëtarë nga Ekzekutivi i Komunës, kjo është një matematikë që tre anëtarë të komisionit të votojnë sipas direktivave të dikujt. Nuk është e ndaluar që komisioni të ketë më shumë anëtarë, dhe unë propozoj që ky numër të zgjerohet në mënyrë që të ketë edhe përfaqësues të Klubit sepse besoj se edhe ata janë të interesuar të marrin informata se si ka shkuar puna deri tani, mandej pse jo të mos ketë përfaqësues të Federatës së Futbollit të Kosovës, dhe kështu numri do të rritej në 7 anëtarë ku nuk do të kishte asgjë të keqe. Ndoshta mënyra se si është bërë me nguti, sepse për këtë pikë do të mund të mbanim edhe seancë të jashtëzakonshme pas disa 3-4 ditësh dhe nuk do të ishim vonuar dhe nuk do të humbim asgjë për këto 3-4 ditë, mirëpo tani po shihet se ne më parë e kaluam edhe një propozim vendim për fillimin e procedurave për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Podujevës, ku neni 3 thotë se, Harta Zonale e Komunës së Podujevës do të përcaktoj sipërfaqet dhe masat për zhvillim ekonomik, zhvillimin e zonave bujqësore, banimit, zonave komerciale etj, shtrohet pyetja, a mos ndoshta parashikohet që aty të bëhet ndërtim i lartë dhe Komuna ta ketë një projekt sepse u tha se asetet do të mbeten në pronësi të Komunës, apo mos ndoshta do të kërkohet dhe është paraqitur që aty të bëhet një ndërtim i lartë, apo si do të veprohet pastaj, unë e di se mbrapa këtij vendimi ka interes të madh që është ndoshta edhe jashtë politikës, por atë do ta themi në kohën e duhur dhe në momentin e duhur.

**z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës**, theksoi, e përmenda më parë se për propozimin e këtij vendimi jam bindur edhe duke u bazuar në informacionet që kam marrë nga Federata e Futbollit të Kosovës. Për sa i takon përbërjes së Komisionit, ne kemi marrë një analogji me rastin e ngritjes së Komisionit për dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim, meqë është përgjegjësi e Kuvendit të Komunës, gjithsesi shumica i takon Kuvendit të Komunës dhe është propozuar një përbërje prej 5 anëtarëve, 2 anëtarë nga Ekzekutivi i Kuvendit dhe 3 anëtarë nga përbërja e Kuvendit. U propozua që përbërja e komisionit të jetë 7 anëtarë, dhe për këtë nuk e kam asnjë telashe që të përfshihen të gjitha Grupet e këshilltarëve dhe përbërja e komisionit të jetë, 2 anëtarë nga Ekzekutivi i Kuvendit, por do të duhej 2 anëtarë nga radhët e LDK-së sepse është partia shumicë në këtë Kuvend, 1 anëtar nga radhët e PDK-së dhe, 1 anëtar nga radhët e LVV-së, dhe 1 anëtarë nga radhët e Grupit Plus. Në një diskutim u ndërlidh hartimi i Hartës Zonale me stadiumin e qytetit, lidhur me këtë ju garantoj që nën udhëheqjen time si Kryetar i Komunës, stadiumi i Klubit të Futbollit "Llapi" do të mbetet stadium, dhe sa për informacion tani është duke u realizuar një fazë e projektit, rregullimi i fushës së gjelbër, ndërsa Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit është në fazën përfundimtare të projektit për rregullimin e tribunave të stadiumit në fjalë, e ritheksoj për deri sa unë të jem Kryetar i Komunës, do të jetë një stadium i qytetit për aq sa i plotëson kushtet e që unë besoj se i plotëson sepse është në qytet dhe mund të zhvillohen garat dhe mund të përdoret për shkollat të futbollit. Në të ardhmen nëse kërkohet diçka tjetër ne në planifikimet tona, varësisht prej mundësive buxhetore mund të caktojmë lokacion tjetër dhe të ndërtojmë stadium të ri. Pra sa më përket mua stadiumi do të mbetet stadium i qytetit ngase unë kam pas mundësi të vendosi që të mos investohet as në fushë të gjelbër e as në tribuna,

por kam vendos që në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit të bëhen investimet e cekura dhe kjo çështje për mua është përfundimisht punë e kryer.

**z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, dëgjua edhe disa sqarime të Kryetarit të Komunës, unë edhe në fillim e thash se lidhur me këtë propozim vendim jemi konsultuar me Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe me Zyrën ligjore. Sa i përket ngritjes së komisionit tani më janë dy propozime të ndryshme ku njëri ishte për 5 anëtarë kurse tjetri ishte për 7 anëtarë, mirëpo fillimisht neve na duhet të votojmë për propozim vendimin e pastaj ta ngrisim komisionin përkatës.

**z.Haki Rudari**, theksoi, ne nuk ishim kundër këtij propozim vendimi por kërkuam që kjo pikë të shtyhet për një seancë tjetër të radhës sepse nuk ishim të përgatitur, por megjithatë kjo hyri si pikë dhe tani na duhet ta trajtojmë. Pajtohemi plotësisht me propozimin e Kryetarit të Komunës që komisioni përkatës të përbëhet prej 7 anëtarëve në mënyrë që të përfaqësohen të gjitha Grupet e këshilltarëve të Kuvendit ku gjithashtu u dha edhe formula e përfaqësimit, mendoj se përmes kësaj formule në një formë do të jenë të përfaqësuar të gjitha Grupet e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës.

**z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, besoj se u dhanë të gjitha sqarimet, andaj e hedh në votim propozim vendimin për iniciimin e procedurave për ndërprerjen e aktivitetit të OJQ - Klubit Publik të Futbollit "Llapi" në Podujevë me qëllim të themelimit të Klubit me organizim në formën e Shoqërisë Aksionare.

*Pas votimit u konstatua se me 21 vota për, asnjë votë kundër dhe 12 vota të përmbajtura u konstatua se u miratua propozimi i vendimit për iniciimin e procedurave për ndërprerjen e aktivitetit të OJQ - Klubit Publik të Futbollit "Llapi" në Podujevë me qëllim të themelimit të Klubit me organizim në formën e Shoqërisë Aksionare.*

**z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, tani kalojmë te formimi i komisionit i cili parashihet në vendimin që sapo u miratua. Kemi dy propozime, njëri është që komisioni të përbëhet prej 5 anëtarëve ndërsa propozimi tjetër është që komisioni të përbëhet nga 7 anëtarë të cilin edhe z.Haki Rudari e përkrahu, andaj e hedh në votim propozimin që komisioni të përbëhet prej 7 anëtarëve.

*Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozimi që komisioni i veçantë për zhvillimin e procedurave të shprehjes së interesit dhe propozimit të aksionarëve në Klubin e Futbollit "Llapi", të përbëhet prej 7 anëtarëve.*

**z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, propozimi për formulën e përbërjes së komisionit ishte, dhe atë si Kryesues i Kuvendit po e formuloj, si vijon; 2 anëtarë nga radhët e Ekzekutivit të Komunës, 2 anëtarë nga radhët e Grupit të këshilltarëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës, 1 anëtar nga radhët e Grupit të Partisë Demokratike të Kosovës, 1 anëtar nga radhët e Grupit të Lëvizjes Vetëvendosje dhe 1 anëtar nga radhët e Grupit Plus. Kërkoj që të propozohen emrat e anëtarëve për komisionin përkatës.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, nuk ka kurrfarë problemi që fillimisht propozimi ishte që komisioni të përbëhej prej 5 anëtarëve, ndërsa tani posa u miratua propozimi tjetër që komisioni të përbëhet prej 7 anëtarëve, mirëpo problemi është tek roli i Kuvendit se ku po jetë. Ne po debatojmë dhe nuk ka insistim për politizim të Klubit të Futbollit "Llapi" por jemi duke debatuar për marrjen e një vendimi, dhe nga njëherë po ndodh që pa dashje

insistimet individuale po na shtyjnë të marrim veprime do të thoja jo shpirtërore veprime të cilat nuk është e logjikshme të ndërmerren. Pra cili po jetë roli i Kryesuesit të Kuvendit kur ai propozon, siç ishte propozimi paraprak që ai e bëri duke propozuar se nga sa përfaqësues të jenë nga Grupet e këshilltarëve dhe sa nga Ekzekutivi i Komunës, është krejt e natyrshme që Kryetari i Komunës të propozoj propozim vendime të ndryshme në Kuvend çfarëdo qofshin ato sepse është e drejtë e tij. Ne si Grup jemi në dijeni për degradimet që na janë bërë neve si këshilltarë në këtë mandat dhe nuk e besoj se ndokush e ndjen veten më keq për rolin e vet si këshilltarë. Pra në njërin anë Kryesuesi i Kuvendit kërkon unifikim politikë për disa çështje kurse në anën tjetër për çështje madhore bënë diskriminim politik të Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit ku për Grupin e LDK-së thotë 2 anëtarë, dhe për Ekzekutivin e Komunës thotë 2 anëtarë, ndërsa për Grupet tjera thotë 1 anëtar. Ju njoftoj se veprimet e mia legale, në lidhje me përfaqësimin e Grupit të këshilltarëve të Kuvendit nga radhët e PDK-së në komisione dhe në Komitete të ndryshme, i kamë marrë përmes prokurorisë, për shkelje të Udhëzimeve Administrative nga ana juaj si Kryesues i Kuvendit, dhe për këtë takohemi e i japim argumentet tona, sepse për këtë çështje disa herë të kam lajmëruar dhe kam kërkuar të luani rolin e juaj si Kryesues i Kuvendit, pra këtë veprim e kam bërë pa dashjen time dhe pa kurrfarë interesi. Ne kërkuam unifikim politik për një vendim, dhe unë propozova që të përfaqësohen të gjitha Grupet por pa propozuar numra, madje kërkoja që në këto procese të na ndihmoj edhe Kryetari i Komunës, po ashtu e thash që në rast se komisioni merr vendim të mirë për Klubin "Llapi" ne e mbështesim ashtu siç i mbështetëm edhe vendimin për themelimin e Spitalit të Përgjithshëm dhe atë për caktimin e palestrës së Sporteve, pra nuk është qëllimi të përfaqësohemi në komisionin përkatës vetëm për të bërë vërejtje, por që të mos e ndjejmë veten të injoruar për vendime për të cilat kërkohet unifikim politik.

**z.Flakron Gashi**, theksoi, dua të sqaroj lidhur me propozimin tim që komisioni në fjalë të përbëhet prej 7 anëtarëve, është e vërtetë që unë propozova ashtu, mirëpo unë nuk thashë që 5 anëtarë të jenë nga Kuvendi i Komunës dhe 2 anëtarë nga Ekzekutivi i Komunës, unë propozova që 3 anëtarë të jenë nga Kuvendi i Komunës, 2 anëtarë nga Ekzekutivi i Komunës, 1 përfaqësues nga Klubi i Futbollit "Llapi" dhe 1 përfaqësues nga Federata e Futbollit të Kosovës, përbërje e cila mendoj se do të ishte më kuptimplotë, nuk do të hapte dyshime për parregullsi të mundshme as te Klubi, as te Kuvendi, as te Ekzekutivi. Kryetari i Komunës ishte ai që e ktheu përbërjen 7 anëtarë, 5 nga Kuvendi i Komunës dhe 2 nga Ekzekutivi i Komunës ku edhe i japi kahje politike, kurse unë isha që komisioni të jetë më i gjerë dhe më i hapur dhe që të ketë transparencë më të madhe, pra unë nuk propozova që në komision të jenë 5 anëtarë nga Kuvendi i Komunës.

**z.Fidan Rekaliu**, theksoi, para pak minutash ne si Kuvend miratuam propozimin që komisioni të përbëhet nga 7 anëtarë, dhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e respektojmë këtë vendim. Propozoj që 2 anëtarë të jenë nga Grupi i këshilltarëve të LDK-së për shkak se duke llogaritur numrin e përgjithshëm të votave të këshilltarëve që kemi në Kuvendin e Komunës, Grupit të këshilltarëve nga radhët e LDK-së i takon që të ketë 2 përfaqësues në përbërjen e komisionit në fjalë.

**z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, tani kemi propozime konkrete, z.Fidan Rekaliu propozoi që në përbërje të komisionit prej 7 anëtarëve të përfshihen 2 anëtarë nga LDK-ja. Po ashtu pak më parë Grupit të këshilltarëve të Lëvizjes Vetëvendosje e mbështeti propozimin sipas formulës së lartcekur, andaj e hedh në votim formulën e përbërjes së komisionit sipas propozimeve, si vijon; 2 anëtarë nga radhët e LDK-së, 1

anëtar nga radhët e PDK-së, 1 anëtar nga radhët e LVV-së, 1 anëtar nga radhët e Grupit Plus dhe 2 anëtarë nga radhët e Ekzekutivit të Komunës.

*Pas votimit u konstatua se me 18 vota për, asnjë votë kundër dhe 12 vota të përmbajtura u konstatua se u miratua formula e përbërjes së komisionit për zhvillimin e procedurave të shprehjes së interesit dhe propozimit të aksionarëve në Klubin e Futbollit "Llapi", si vijon; 2 anëtarë nga radhët e Ekzekutivit të Komunës, 2 anëtarë nga radhët e Grupit të këshilltarëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës, 1 anëtar nga radhët e Grupit të Partisë Demokratike të Kosovës, 1 anëtar nga radhët e Grupit të Lëvizjes Vetëvendosje dhe 1 anëtar nga radhët e Grupit Plus.*

**z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, tani kërkohet të propozohen emrat e anëtarëve të komisionit, Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës në formë të shkruar i ka propozuar z.Bahri Blakqorin dhe z.Fidan Rekalium, ndërsa nga Grupet tjera kërkohet të bëjnë propozimet.

**z.Rafet Llapashtica**, nga Grupi i këshilltarëve të PDK-së propozoi z.Fatmir Rudarin.

**z.Haki Rudari**, nga Grupi i këshilltarëve të LVV-së propozoi z.Bahri Selimin.

**z.Naim Çunaku**, nga Grupi i këshilltarëve të Grupit Plus propozoi z.Naim Çunakun.

**z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës**, nga radhët e Ekzekutivit të Komunës propozoi z.Abaz Llugaliun dhe z.Avni Fetahun.

**z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, nënvizoi, konstatoj se u japën të gjitha propozimet e emrave të komisionit të veçantë për zhvillimin e procedurave të shprehjes së interesit dhe propozimit të aksionarëve në Klubin e Futbollit "Llapi", në këtë përbërje; Abaz Llugaliu, Avni Fetahu, Bahri Blakqori, Fidan Rekalium, Fatmir Rudari, Bahri Selimi dhe Naim Çunaku. Andaj e hedh në votim.

*Pas votimit u konstatua se njëzëri u ngrit Komisionit për zhvillimin e procedurave të shprehjes së interesit dhe propozimit të aksionarëve në Klubin e Futbollit "Llapi" në këtë përbërje:*

1. Abaz Llugaliu, nga Ekzekutivi i Komunës
2. Avni Fetahun, nga Ekzekutivi i Komunës
3. Bahri Blakqori, këshilltar i Kuvendit
4. Fidan Rekalium, këshilltar i Kuvendit
5. Fatmir Rudari, këshilltar i Kuvendit
6. Bahri Selimin, këshilltar i Kuvendit
7. Naim Çunaku, këshilltar i Kuvendit

**8. Propozimi i vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS**

**z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, meqë drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë nuk ka diçka më shumë të japë arsye të rreth këtij propozim vendimi se sa që e bëri në fjalën hyrëse në fillim të kësaj mbledhje, dhe nëse nuk ka këshilltarë të Kuvendit për diskutim, unë e hedh në votim këtë propozim vendim.

*Pas votimit u konstatua se me 18 vota për, 9 vota kundër dhe 3 vota të përmbajtura u miratua propozimi i vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS.*

**9. Të Ndryshme**

*Nuk pati këshilltarë të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi mbledhjen të përfunduar.*

**Mbledhja përfundoi në orën 11:55**

**Procesverbalin e mbajti  
Enis Sheholli**

**Nr. 01-006-52449  
Podujevë,  
29 qershor 2016**

**Kryesuesi i Kuvendit  
Mehmet Gashi**